



PERGJIGJA E FORUMIT ALB-SHKENCA NDAJ NJE DEKLARATE TE DISA ORGANIZATAVE GREKO-AMERIKANE

Të nderuar anëtarë dhe lexues të Alb-Shkencës, siç mund të jeni në dijeni, në një deklaratë të lëshuar nga disa shoqata greke në Amerikë të titulluar “2005 Greek American Policy Statement”, shkruhej (marrë nga teksti original i deklaratës):

8. Albania

Although some improvements have been made lately in the conditions and treatment of the Greek minority, continuing acts of discrimination and persecution tolerated by the government of Albania against the nation's ethnic Greek minority constitute subtle ethnic cleansing aimed at making ethnic Greeks feel isolated, powerless and vulnerable so that they will abandon their homes and move south to Greece.

The personal safety of ethnic Greeks in Albania is also at risk by reason of direct intimidation by security forces and the burning of schools, churches and businesses by lawless bands that the police allow to operate with impunity. Nowhere are ethnic Greeks given a fair deal or even a fair count. Although Albania successfully sought a census to measure the Albanian minority in neighboring FYROM, its government resists the demand of the European Union to measure its minorities, so it can continue to claim that the Greek minority is small when it constitutes at least 10 percent of the country's 3.5 million population.

We call on the U.S. government, in its own interest and the interest of maintaining peace and stability in the southern Balkans, to undertake an intense diplomatic dialogue with the government of Albania to ensure that the rule of law is observed and minority and basic human rights are protected. The U.S must make clear that Albania must treat its minorities fairly and humanely the way it wants Albanian minorities in neighboring countries to be treated.

Në përgjigje të kësaj deklarate, Alb-Shkenca, Forumi Mbarëkombëtar i Studiuesve Shqiptarë, pergatiti letrën për Kongresin amerikan që vazh-

don më poshtë, versionin shqip të së cilës e përgatiti Dr. Arben Kallamata.

Falenderojmë sërish nismëtarët dhe të gjithë anëtarët e Alb-Shkencës që dhanë kontributin e tyre në hartimin, saktësimin dhe redaktimin e kësaj letre.

Të nderuar Zonja e Zotërinj,

jemi një grup shkencëtarësh dhe kërkuesish shkencorë shqiptarë që punojmë në të katër anët e botës, anëtarë të Forumit të Studiuesve Shqiptarë “Alb-Shkenca” i krijuar për të nxitur zhvillimin e shkencës dhe arsimit ndër shqiptarët. Këtë letër po e shkruajmë në përgjigje të një Qëndrimi Politik për Shqipërinë të qarkulluar nga Instituti Helenik Amerikan¹ dhe të mbështetur nga disa organizata Greko-Amerikane² (Urdhëri i AHEPA-s, Këshilli Kombëtar Helenik Amerikan, Federata Qipriote e Amerikës, Federata Panepirote e Amerikës, Shoqata Pan-Maqedonase e Amerikës, Shoqata Evrytaniane e Amerikës dhe Instituti Helenik Amerikan). Me anë të këtij Qëndrimi Politik i kërkohet qeverisë së SHBA-së të sigurojë respektimin e të drejtave të pakicave greke në Shqipëri nga qeveria shqiptare.

Ne mendojmë se pakicat greke në Shqipëri jo vetëm që respektohen ashtu si duhet, por edhe luajnë një rol të rëndësishëm në procesin politik. Si përpara, ashtu edhe pas rënies së komunizmit në vitin 1990³, pakicat greke në Shqipëri kanë gëzuar të njëjtat të drejta shoqërore, politike dhe ekonomike, si dhe të njëjtin nivel jetese me të gjithë qytetarët e tjerë të Shqipërisë. Pjesëtarët e pakicave greke jo vetëm që nuk janë përndjekur si të tillë, por edhe janë ngritur në pozitat më të larta vendimmarrëse, qeverisëse dhe ligjvënëse si Ministra

¹ Shih AHI HYPERLINKS (2005):

http://www.aheworld.com/press_releases/052005.html;

http://www.aheworld.com/policy_statement.html#8 [20 July 2005]

² Shih AHI HYPERLINKS (2005): *Idem*

³ Shih Vickers, Miranda dhe Pettifer, James (2001). *Albania: from Anarchy to a Balkan Identity*. Hurst & Company, London 1997, f. 193-200. Gjithashtu shih Pettifer, James. *The Greek Minority in Albania in the Aftermath of Communism*. Conflict Studies Research Centre. July 2001.

HYPERLINK <http://www.da.mod.uk/CSRC/documents/balkans/G97>

(anëtarë të Kabinetit) dhe Deputetë të Kuvendit⁴.

Akuzat e bëra për djegien e shkollave, kishave dhe bizneseve greke janë thjesht të pavërteta. Shkolla greke janë hapur dhe funksionojnë rregullisht jo vetëm në Shqipërinë e Jugut, ku ndodhen bashkësitë e pakicave greke, por edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë si Tirana dhe Korça, pavarësisht nga rreziku i përhershëm i kthimit të tyre në çerdhe të përhapjes së doktrinës shoviniste greke të "Megali-Ideas"⁵ në Shqipëri.

Instituti Helenik Amerikan dhe organizatat e tjera greko-amerikane ankohen se qeveria shqiptare iu krijon shumë pak mundësi zhvillimi pakicave greke dhe, në përgjithësi, Greqisë. Përkundrazi, kompanive greke iu është dhënë monopol në sektorët më strategjikë të ekonomisë shqiptare, si në banka, në komunikacionin e lëvizshëm dhe në infrastrukturë.⁶ Për më tepër, të akuzosh Shqipërinë për "pastrim etnik" të ngjashëm me atë që u krye nga regjimi serb në Bosnje dhe në Kosovë s'përbën gjë tjetër veçse një shtrembërim të pashembullt faktesh dhe falsifikim të hapur. Shkalla e lartë e migrimit ka qënë dukuria më e rëndomtë për të gjithë shqiptarët gjatë periudhës së kalimit nga një ekonomi e përqendruar në ekonominë e tregut, dukuri e shtyrë krejtësisht nga shtrëngesat ekonomike. Një

tjetër pretendim çorientues ka të bëjë me numrin e grekëve etnikë në Shqipëri, i cili nuk është 400.000 (rreth 10% e popullsisë) por rreth 60.000.⁷

Në kohën që disa organizata greke e akuzojnë Shqipërinë për "pastrim etnik, keqtrajtim, përndjekje, diskriminim", janë shqiptarët që jetojnë dhe punojnë në Greqi ata që bien vazhdimisht pre e një trajtimi të tillë. Historia e kohëve të fundit na jep dëshmi rrëqethëse, duke nisur me pastrimin e egër dhe sistematik etnik të viteve 1944-45 të të paktën 30.000 çamëve⁸, një pakicë etnike shqiptare e vendosur në Greqinë Veriperëndimore; vrasjen e kohëve të fundit të emigrantit shqiptar 20 vjeçar Gramoz Palushi në ishullin e Zakynthos menjëherë pas ndeshjes së futbollit Shqipëri-Greqi në shtator 2004; e deri te dhunimet ndaj flamurit shqiptar të tifozëve ekstremistë grekë gjatë ndeshjes së futbollit Greqi-Shqipëri në mars të vitit 2005⁹.

Pavarësisht nga numri i madh i shqiptarëve në Greqi¹⁰ (ku përfshihen pakicat shqiptare atje dhe emigrantët e kohëve të fundit), në Parlamentin grek nuk ka asnjë deputet shqiptar; nuk ka parti politike që të përfaqësojnë interesat e pakicave shqiptare dhe të emigrantëve të kohëve të fundit në Greqi, ndërsa në qeverinë greke nuk ka asnjë shqiptar që të mbajë portofolin e ministrit. Jo vetëm kaq,

⁴ Pakicat greke përfaqësohen nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), megjithëse pesëtarë të këtyre pakicave përfaqësohen edhe si anëtarë të partive të tjera. Kjo parti e themeluar nga grekët etnikë ka fituar shumicën e vendeve të zgjedhura në tre zona të Shqipërisë së Jugut (Sarandë, Gjirokastrë dhe Delvinë). Në Parlamentin shqiptar ka tre anëtarë që janë grekë etnikë, dy prej të cilëve përfaqësojnë Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Qeveritë lokale të tri rrethëve jugore, si edhe kryebashkiaku i një prej qyteteve të mëdhenj janë grekë etnikë." Burimi: US Embassy Sweden: *Country Reports on Human Rights Practices for 1995 - Albania*. Botuar nga Zyra e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punës, Departamenti i Shtetit i SHBA-së. Mars 1996.

HYPERLINK <http://www.usemb.se/human/1995/europe/albania.html>
Praktikisht kjo parti mban tre vende në Kuvendin e Shqipërisë, i dalë nga zgjedhjet e vitit 2001. (Burimi: *CIA World Factbook* (2005): Albania.

HYPERLINK <http://www.odci.gov/cia/publications/factbook/geos/al.html>
Më 15 Korrik 2005 udhëhoqësi i Partisë Demokratike Sali Berisha ftoi PBDNJ-në që t'i bashkojë koalicionit që do të drejtojë qeverinë shqiptare. Burimi: (BBC 2005): HYPERLINK http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2005/07/050715_berisha_koalicion.shtml [20 July 2005])

⁵ Ose "Ideja e Madhe". Kjo përbën bazën e nacionalizmit grek, që mund të konsiderohet si i barazvlefshmi i "Nacertanie"-s serbe. Ideja nënkupton qëllimin për të bashkuar të gjitha territoret ku kanë jetuar dikur grekët në një shtet të përbashkët grek. Për shembuj mund t'i drejtoheni: Soward, Steven W. *Greek Nationalism, the Megale Idea and Venizelism to 1923*. Në: *Twenty-five lectures on Modern Balkan History (The Balkans in the Age of Nationalism)*, Lecture 14.
HYPERLINK <http://www.lib.msu.edu/sowards/balkan/lect14.htm>

⁶ "Prania në rritje e investimeve dhe ndërmarrjeve greke në ekonominë shqiptare luan një rol të rëndësishëm edhe në marrëdhëniet dypalëshe. Greqia renditet vetëm pas Italisë si partner kryesor tregëtar i Shqipërisë. Gjatë vitit 2002 vëllimi tregëtar arrinte në 371.7 milionë dollarë (eksportet greke 322.1 milionë, importet greke 49.6 milionë). Sipas të dhënave të Shërbimit Statistikor Kombëtar në tremujorin e parë të vitit 2003 vëlli-

mi i tregëtisë arrinte në 145.2 milionë (eksportet greke 130.5 milionë, importet greke 14.7 milionë dollarë). Ndërsa përsa i përket investimeve greke, shuma e përgjithshme i kalon 300 milionë, duke përfaqësuar 27% të të gjithë sasisë së investimeve të huaja në Shqipëri, shifër që e ve Greqinë në radhën e parë të investuesve të huaj. Rreth 200-300 ndërmarrje greke janë përfshirë aktivisht në sektorët e mëposhtëm: telekomunikacion, tregëti e produkteve të naftës, shërbime bankare, industri e ndërtimeve, ushqimore, tekstileve, veshjeve dhe këpucëve.

Ndër më të rëndësishmet prej tyre janë: Institutet bankare: Banka Kombëtare, Banka Tregëtare, Alpha Bank dhe Tirana Bank (Piraeus); shoqëritë e telekomunikacionit: Albanian Mobile Communications (Cosmote), Vodafon Albania (Vodafon/Panafon); shoqëritë e naftës: Global Ltd (Hellenic Petroleum), Mamidakis Oil, dhe Diekat Ate; Tobacco Mihailides S.A. dhe Kavex Tobacco Industry; Quest Albania Computer Company. (Burimi: Ministria greke e Punëve të Jashtme 2005):

HYPERLINK http://www.mfa.gr/english/foreign_policy/europe_southeastern/balkans/albania.html [20 July 2005]

⁷ Shih *CIA Worldfactbook* (2005): Albania.

HYPERLINK <http://www.odci.gov/cia/publications/factbook/geos/al.html>
Gjithashtu shih: Bureau of European and Eurasian Affairs (2005): *Background note: Albania*.

HYPERLINK <http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/3235.htm> [20 July 2005]

⁸ Shih Vickers, Miranda. *The Cham Issue - Albanian National & Property Claims in Greece*. Conflict Studies Research Centre. April 2002.

HYPERLINK <http://www.da.mod.uk/CSRC/documents/balkans/G109>

⁹ Shih *Sportline* - Greek Sports Agency (2005).

HYPERLINK http://www.sport.gr/news/050330/wc2006_alva.asp

(March 30, 2005). [20 July 2005].

Gjithashtu shih: Arun, Neil (2005): *Albanian fans cry fool at Greek "ban"*. Article in BBC News, 1 April 2005.

HYPERLINK <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/4397921.stm>

¹⁰ Duhet bërë dallimi midis dy termave "pakicë shqiptare" dhe "bashkësi" shqiptare. Termi "pakicë shqiptare" i përket arvanitasve dhe çamëve,

por qeveria greke mohon¹¹ edhe vetë ekzistencën e pakicave shqiptare. Në Greqi nuk ka shkolla shqipe, pavarësisht nga masa e konsiderueshme e bashkësisë shqiptare atje.

Mënyra se si disa organizata greko-amerikane shtrembërojnë historinë dhe gjeografinë është skandaloze, megjithëse jo e papritur për ne, sepse nuk është hera e parë. Ta quash Shqipërinë e Jugut, ose të Poshtme "Epiri i Veriut" dhe të pretendosh se ajo përbën një krahinë greke s'është gjë tjetër veçse pasaktësi. Epiri, ose Shqipëria e Jugut, është krahinë historikisht shqiptare. Politika e fryrjes së pretendimeve territoriale ndaj kësaj pjese të Shqipërisë s'bën gjë tjetër veçse dëmton paqen dhe qendrueshmërinë në Ballkan.

Shqiptarët dhe grekët janë ndër popujt më të vjetër të Ballkanit. Si fqinjë të lashtë ne kemi shu-

më gjëra të përbashkëta në histori, kulturë dhe traditë. Ne jemi të bindur se marrëdhëniet e mira midis fqinjëve mund të arrihen vetëm me qëndrime miqësore, konstruktive, të paanëshme dhe të qytetëruara. Bashkëpunimi, respekti i dyanshëm, besimi dhe miqësia me njeri-tjetrin në fushat me interes të përbashkët janë kushte të domosdoshëm për paqe dhe qëndrueshmëri në rajon.

Me respekt,
Alb-Shkenca, Forumi i Studiuesve Shqiptarë
(www.alb-shkenca.org,
alb-shkenca@alb-net.com)

Informacion kontakti:
Alb-Shkenca, The Forum of Albanian Scholars
1720 Hunt Avenue, Richland, WA 99352, USA

ndërsa "bashkësia shqiptare" përfshin pakicat shqiptare dhe emigrantët shqiptarë që kanë kaluar vitet e fundit në Greqi për arsye ekonomike. Pjestarët e krishterë të pakicave shqiptare në Greqi e njohin veten si arbërorë, *arvanitas* në greqisht. Në Greqinë Veriperëndimore ata e quajnë veten shqiptarë (i njëjti term përdoret edhe nga shqiptarët e Shqipërisë). Gjuha e tyre amtare, arvanitika i përket familjes gjuhësore të shqipes dhe rrjedh nga njeri prej dy grupeve gjuhësore të saj, toskërishtes së Shqipërisë së Jugut (Shih: Greek Helsinki: *Report - The Arvanites*.

HYPERLINK <http://www.greekhelsinki.gr/english/reports/arvanites.html>
Të dhëna për pakicën shqiptare (arbërorë/arvanitas): "Qysh nga viti 1951 nuk ka asnjë të dhënë as për këtë grup dhe as për ndonjë grup tjetër pakicash në Greqi (ndërsa statistikisht më të hershme janë përgjithësisht jo të besueshme, sepse më së shumti pasqyrojnë parapëlqime të forta etnike.) Vlerësimi më i saktë që mund të gjendet sot për popullsinë që flet gjuhën dhe/ose ka ndërgjegje arvanitase është që ata arrijnë deri në 200.000. Trudgill (1983:128) jep një llogaritje prej 140.000 shqipfolësish në Atikë dhe Beotia, shifër që përmendet edhe nga Hill (1990:135). Ciampi (1985:87) jep shifrën 30.000 për arvanitasit e Veriperëndimit, dhe po ai llogarit të jenë gjithsej 156-201.000 në të gjithë grupin. Disa pjestarë të vetë bashkësisë japin shifra shumë më të larta, që shkojnë deri në 1.600.000 (Kormoss, 1994:1 dhe Gerou, 1994b:2): kjo shifër mund të nënkuptojë të gjithë grekët që kanë ndonjë prejardhje arvanitase, dhe nuk i takon me doemos numrit të tanishëm të shqipfolësve ose atyre që kanë vetëdije të ngjashme. Ashtu si edhe gjuhët e tjera të pakicave, me përjashtim të turqishtes, arvanitika-ja nuk gëzon status ligjor në Greqi dhe nuk jepet mësim në ndonjë hallkë të sistemit arsimor. (Burimi: Greek Helsinki: *Report - The Arvanites*.

HYPERLINK <http://www.greekhelsinki.gr/english/reports/arvanites.html>
Censusi zyrtar i vitit 1951 në Greqi tregoi se pakicat etnike në vend përbënin 2.6-3.8% të gjithë popullsisë. Por, ashtu siç ndodhi edhe me jोगrekët e tjerë, numri i shqiptarëve në këtë census paraqitej shumë i zvogëluar. Sipas burimeve të tjera, në atë kohë duhet të ketë pasur të paktën 350.000 shqiptarë. (Burimi: Mete, Eqerem. *Qëndrimi grek ndaj pakicave kombëtare*. Artikulli i botuar në gazetën shqiptare *Albania*, dhjetor 2000.

http://www.aacl.com/Greece_Stand_on_National_Minorities.htm
Anëtarët muslimanë të pakicave shqiptare quhen çamë. Pas Luftës së Dytë Botërore ata ranë viktimë të një spastrimi etnik të egër dhe sistematik nga ana e forcave të Partisë Nacional Republikane të gjeneralit Zervas. Për informacion të mëtejshëm drejtohuni shënimit 8.

Përsa i përket emigrantëve shqiptarë (pas rënies së diktaturës komuniste) "Sot për sot ka emigruar rreth 25 përqind e gjithë popullsisë, ose mbi 35 përqind e forcës së punës. Vendi ka afërsisht 900.000 emigrantë të cilët tani kanë zënë vend kryesisht në Greqi (600.000), Itali (200.000) dhe në pjesën tjetër të vendeve të Europës Perëndimore, në SHBA dhe Kanada. Rrjedha e emigrantëve shqiptarë që nga fillimet e viteve 1990

ka qënë pesë herë më e lartë se rrjedha mesatare e migracionit në vendet në zhvillim." (Burimi: Barjaba, Kosta. *Albania looking beyond the borders*. In: Migration Information Source, August 2004.

HYPERLINK <http://www.migrationinformation.org/Profiles/display.cfm?ID=239>
BBC News e përcakton numrin e shqiptarëve në Greqi (bashkësi) diku tek 800.000. Shih: Arun, Neil: *Albanian fans cry fool at Greek "ban"*. Article in BBC News, 1 April 2005.

HYPERLINK <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/4397921.stm>
Burime më të vjetra për emigrantët shqiptarë në Greqi: "Veç këtyre ja vlen të përmendet që nga fundi i vitit 1999 se numri i emigrantëve shqiptarë që paguanin sigurime shoqërore në Greqi ishte rreth 200.000 (CESS, 2000). Këto të dhëna tregojnë se numri i imigrantëve shqiptarë në Greqi nuk mund të jetë më i vogël se 500.000." (Burimi: Barjaba, Kosta. *Contemporary patterns in Albanian emigration*. In: South-East Europe Review, 2/2000, p. 61).

HYPERLINK http://www.boeckler.de/pdf/South-East_Europe_Review-2000-02-p057.pdf
"Numri i imigrantëve shqiptarë që kanë kaluar në Greqi midis viteve 1990 dhe 1994 vlerësohet të jetë 250.000." (Burimi: Vidali, Maria. *Living in a Policy Vacuum. The plight of Albanian immigrants in Greece*. In: Central Europe Review, Vol.1, No.21, 15 November 1999.

HYPERLINK <http://www.ce-review.org/99/21/vidali21.html>
"Siç përmendet edhe më sipër, pjesa më e madhe e imigrantëve të punësuar ilegalisht në Greqi përbëhet nga shqiptarët. Megjithatë, numri i tyre luhet nga 150.000, sipas vlerësimeve të Mr. Skoularikis deri në proporcionalisht 350-500.000 sipas vlerësimit të Mr. Papatthemelis." (Burimi: Greek Helsinki Monitor. *Greeks of Albania and Albanians in Greece*. September 1994.

HYPERLINK <http://www.greekhelsinki.gr/pdf/ghm-greeks-albanians.PDF>
¹¹ Shih: CSCE: *CSCE Communication*, No.35. Vienna, 14 November 1994.

HYPERLINK http://www.osce.org/documents/hcnm/1994/11/2702_en.pdf
Komente të Komitetit Grek të Helsinkit për praninë e pakicave shqiptare në Greqi: "Duhet përmendur këtu se gati një çerek milioni grekë i përkasin familjeve që tradicionalisht kanë gjuhë amtare atë që ata e quajnë në gjuhën e tyre *arberichte* ose *arvanitika* në greqisht, gjuhësisht i përkasin grupit të gjuhëve shqipe dhe, më saktë, nëngrupit Tosk (Shqipëria e Jugut). (Burimi: Greek Helsinki (1998):

HYPERLINK <http://www.greekhelsinki.gr/english/articles/AIM29-9-1998.html>
Më tej: "Për fat të keq, shteti grek, duke e vënë në dyshim fare pa të drejtë besnikërinë e tyre iu ka imponuar asimilimin, gjë që ka çuar në uljen e ndjeshme të përdorimit të gjuhës dhe, si kundërpeshë ndaj kësaj, i ka detyruar shumicën e tyre të kthehen në nacionalistë të vendosur... (Burimi: Greek Helsinki (1998): HYPERLINK

HYPERLINK <http://www.greekhelsinki.gr/english/articles/AIM29-9-1998.html>
Shih gjithashtu: Vickers, Miranda (2002). *The Cham Issue - Albanian Nation (vijnë në faqen 11)*

STATUTI I RI I ALB-SHKENCES DHE VOTIMI PER TE

Më datë 7 korrik 2005 u mbyll në grupin e punës procesi i votimit për statutin e ri të Alb-Shkencës. Më tej dëshirojmë t'ju shtojmë përpara procesin nëpërmjet të cilit do të mbërrijmë dhe në votimin e statudit në rang forumi dhe çfarë do të ndodhë pas tij.

Proceset e paravotimit dhe votimit

Në adresën e forumit <http://www.alb-net.com/mailman/private/alb-shkenca/2005-July/003004.html> është teksti i statudit që doli fitues në votimin e kryer në grupin e punës e gjithashtu edhe teksti i cili mori numrin e dytë më të madh të votave. Bazuar mbi këta dy tekste ju mund të jepni propozime plotësuese e përmirësuese. Propozimet duhet të jenë thelbësore, të kenë të bëjnë me përmbajtjen dhe jo me formën, e cila do të përmirësohet me kalimin e kohës. E rëndësishme për t'u ditur qysh në fillim është se kuotën e anëtarësisë nuk e kemi dhënë me shifra, por e kemi lënë për ta diskutuar në forum. Meqenëse diskutimi i statudit të Alb-Shkencës koincidi me periudhën e pushimeve të verës, mendojmë që për të lexuar tekstin dhe për të dhënë mendimet të lemë një afat kohor deri në mes të muajit shtator. Mendimet e sjella do të mblidhen dhe do të krijohen alternativa votimi, të cilat në vazhdim do të paraqiten për votimin përfundimtar. Në varësi të numrit të alternativave të krijuara do të formulohet dhe teksti i cili do t'ju paraqitet për votim. Nëse do të ketë vetëm një alternativë, atëhere teksti do të jete:

Pro – Kundra – Abstenim

Nëse do të ketë më shumë se një alternativë, atëhere paraqitja do të kete një formë si e mëposhtjma:

Varianti 1 – Varianti 2 – Varianti 3 – Asnjë nga variantet

Si do të zhvillohet votimi?

Kur alternativat për votim të jenë gati, atëhere përmes një e-maili nga adresa: votimiistatutit@alb-shkenca.org do të ftoheni për votim. Mesazhi do të dërgohet në të gjitha adresat tuaja personale e në adresën grupune@alb-shkenca.org, moderatori@alb-shkenca.org dhe alb-shkenca@alb-net.com. Kjo bëhet për qëllime transparence dhe dokumentimi.

Së pari, vota që do dërgojmë shërben njëkohësisht si pranim i qëllimit tonë për të qenë anëtarë të institutit Alb-Shkenca. Personave që nuk marrin pjesë në votim në këtë fazë do t'ju duhet të regjistrohen në mënyrat e parashikuara në statutin në një moment të mëvonshëm.

Së dyti, vota do të jepet me e-mail, i cili për efekt numërimi do të dërgohet në adresën: votimiistatutit@alb-shkenca.org dhe për efekt transparence dhe dokumentimi do të dërgohet në adresat grupune@alb-shkenca.org, moderatori@alb-shkenca.org dhe alb-shkenca@alb-net.com.

Numërimi i votave do të kryhet nga grupi administrues (i cili qysh prej fillimit të qershorit, pas një diskutimi paraprak midis administratorëve që kanë drejtuar punët e forumit Alb-Shkenca dhe portalit Alb-Shkenca.org Niko Qafoku, Neim Rustemi dhe Roland Leli është zgjeruar duke përfshirë krejt anë-

tarët e grupit të punës). Ky grup administrues do të shpërbëhet pas zgjedhjes së organeve të institutit Alb-Shkenca.

Meqë gjithsecili do të ketë mundësi të kontrollojë ecurinë e votimit on-line, përmes ndjekjes së publikimit të votës së tij në adresën alb-shkenca@alb-net.com, gjithsecili ka mundësinë edhe të një kontrolli të përgjithshëm. Qellimi i vetëm është transparence. Votat që do të vijnë pas orës së caktuar si afat përfundimtar për votim nuk do të pranohen.

Grupi përgjegjës do të ndjekë nga afër procesin e votimit përgjatë gjithë kohës, numërimi do të bëhet gradualisht, sipas fluksit të dhënies së votave dhe rezultati përfundimtar do të jepet shumë shpejt pas mbylljes së votimit.

E-maili informues do të përmbajë këto të dhëna:

– sa personave iu dërgua e-maili lajmërues dhe ftues për votimin (me tekstet alternative në brendi);

– sa prej tyre morën pjesë në votim (duke vendosur kësh-tu të kthehen në anëtarë të Alb-Shkencës);

– si votuan këta persona (variantet e votuara do të rreshtohen sipas numrit të votave të marra e krahas tyre do të jepen emrat e personave dhe data e mbërritjes së e-mailit të tyre.

– rezultati i votimit pas shqyrtimit të votave të dhëna.

Ju ftojme pra që të merrni pjesë aktivisht në këtë proces paravotimi nëpërmjet diskutimit dhe dhënies së alternativave tuaja dhe në atë të votimit. E rëndësishme është që të mund të hartojmë një statut cilësor, me të cilin instituti i ardhshëm Alb-Shkenca të mund të regjistrohet pranë organeve përkatëse shtetërore.

Çfarë do të ndodhë në vazhdim?

Së pari, qysh prej datës 9 korrik 2005 mund të thuhet se ka nisur zyrtarisht puna për përgatitjen e një plani biznesi për institutin e ardhshëm. Tre pjestarë të grupit të punës kanë marrë përsipër të përfshihen në përgatitjen konkrete të këtij plani. Gjithsecili prej jush, me njohuri e përvojë në këtë fushë, është i ftuar të marrë pjesë në këto përgatitje. Për këtë mjafton një e-mail në adresat: grupune@alb-shkenca.org dhe moderatori@alb-shkenca.org.

Gjithashtu ju ftojme që të jepni mendimet tuaja mbi të ardhmen e Alb-Shkencës, çfarë projektesh konkrete mendo-ni ju për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Ato do të përbëjnë një bazë të mirë për ngritjen e llogarive pjesë të planit. Këto mendime mund t'i jepni drejtpërdrejt në forumin tonë ose në adresat e sipërpërmendura.

Pas votimit të statudit do të kryhet regjistrimi i institutit Alb-Shkenca pranë organit përkatës në Tiranë dhe pas formulimit të *business planit* do të bëhet thirrja për Mbledhjen e Përgjithshme të Institutit.

Ju urojmë lexim të mbarë të dy teksteve që kemi dërguar me e-mail me besimin e një pjesëmarrjeje aktive tuajën në votimin e statudit të ri.

Per Grupin Administrues te Alb-Shkences

Lindita Komani

Të renditur më poshtë do të gjeni disa nga publikimet shkencore të anëtarëve të Alb-Shkencës gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2005 për tu njohur më nga afër me veprimtarinë e tyre kërkimore. Për ti dhënë një shtytje të mëtejshme edhe punës studimore-shkencore dhe bashkëpunimit më të gjerë në trojet shqiptare, një pjesë e mirë e këtyre punimeve dhe rezultatet e tyre i ofrojmë për ata që janë të interesuar.

SHKENCAT E NATYRES

Derera N.F., Nagy N. and Hoxha A. *Condiment paprika research in Australia*, Journal of Business Chemistry, Vol. 2, Issue 1 (January 2005). www.bussinesschemistry.org

Caliandro R., Carrozzini B., Cascarano G.L., De Caro L., Giacobozzo C., Moustiakimov M. & Siliqi D. *The partial structure with errors: a probabilistic treatment*, Acta Cryst. A61, 343-349 (2005).

Caliandro R., Carrozzini B., Cascarano G.L., De Caro L., Giacobozzo C., Siliqi D. *Phasing at resolution higher than the experimental resolution*, Acta Cryst. D61, 556-565 (2005).

SHKENCAT POLITIKE DHE SHOQERORE

Bogdani M. *Albania and the EU*. Presentation at University of London, UCL. Seminar series organised by the Centre for South-East European Studies. London, UK (3 March 2005).

Bogdani M. *Europeanisation of Albania and its impact on the political party system*. Presentation at Bristol University, School of Policy Studies. Bristol, UK (9 March 2005).

Bogdani M. *Transition Period in Albania: Historical, Political, Economic and Cultural Legacies of the Past and the Challenges of the Present*. Published at "Fryma e filozofisë" (May 2005).

Sulstarova E. *Kultura disiplinuese, perëndimi dhe të tjerët e tij*. Gazeta "Fjala", Tiranë (16 janar 2005).

Sulstarova E. *Drejt një metode për studimin e orientalizmit shqiptar*. Gazeta "Fjala", Tiranë (27 mars 2005).

Sulstarova E. *Fillesat e orientalizmit shqiptar*. Gazeta "Fjala", Tiranë (8 dhe 15 maj 2005).

Ypi L.L. *The Albanian Renaissance in political thought: between the Enlightenment and Roman-*

ticism, John Kennedy School of Government, Harvard University, USA (January 2005).

www.ksg.harvard.edu/kokkalis/GSW7/Ypi%20paper_.pdf

Ypi L.L. MA thesis, *The European constitutional debate. The integration process of the Union in the radical left press*, University of Rome La Sapienza (April 2005).

Ypi L.L. *Cosmopolitanism, Sovereignty and the Ethics of European Foreign Policy*, London School of Economics and King's College London, European Foreign Policy Conference July 2005.

<http://www.lse.ac.uk/Depts/intrel/EFPC/Papers/YPI.pdf>

SHKENCAT E BUJQESISE DHE MJEDISIT

Berisha B. and Schams D. *Ovarian function in ruminants*. Domestic Animal Endocrinology 2005; 29:305-317.

Schams D., Welter H., Berisha B. *The expression of MMP family members in bovine follicles before and after LH surge and in luteal tissue*. 49th Annual Meeting of the German Society of Endocrinology (DGE, Münster, March 9-12th 2005). Exp Clin Endocrinol Diabetes 2005; 113: S26.

Berisha B., Miyamoto A., Schams D. *The expression of angiopoietin-tie system members in CL during oestrous cycle and induced luteolysis in cow*. 49th Annual Meeting of the German Society of Endocrinology (DGE, Münster, March 9-12th 2005). Exp Clin Endocrinol Diabetes 2005; 113: S27.

Schams D., Welter H., Berisha B. *The expression of plasminogen activator (PA) family members in bovine follicles before and after LH surge and in luteal tissue*. 38. Jahrestagung Physiologie und Pathologie der Fortpflanzung 10-11.02.2005 Zürich. DVG-Zürich-2005. Schweizer Archiv für Tierheilkunde 2005; 147 (2): 74.

Berisha B., Welter H., Meyer H.H.D., Schams D. *The expression of VEGF and its receptors in bovine follicle before LH surge, after LH surge and in early corpus luteum (CL)*. 38. Jahrestagung Physiologie und Pathologie der Fortpflanzung 10-11.02.2005 Zürich. DVG-Zürich-2005. Schweizer Archiv für Tierheilkunde 2005; 147 (2): 50.

Ulbrich S.E., Poschke I., Welter H., Meyer H.H.D., Schams D, Berisha B. *Expression of nitric oxide synthases (NOS) in the bovine corpus luteum*

during the estrous cycle and after induced luteolysis. 38. Jahrestagung Physiologie und Pathologie der Fortpflanzung 10-11.02.2005 Zürich. DVG-Zürich-2005. Schweizer Archiv für Tierheilkunde 2005; 147 (2): 81.

Berisha B., Neuvians T.P., Schams D. *The expression of angiogenic factors (VEGF and Angiopoietins) in corpus luteum during induced luteolysis in cow.* 38. Jahrestagung Physiologie und Pathologie der Fortpflanzung 10-11.02.2005 Zürich. DVG-Zürich-2005. Schweizer Archiv für Tierheilkunde 2005; 147 (2): 49-50.

Gruda N., Prasad M., Maher M.J.: *Soilless Culture*. In: Lal. R. (Ed.) *Encyclopedia of Soil Sciences*. Dekker Encyclopedias - A Product Line from Taylor & Francis Books, New York.
<http://www2.dekker.com/sdek/abstract~db=enc~content=a713572084>

Gruda N. *Impact of Environmental Factors on Product Quality of Greenhouse Vegetables for Fresh Consumption*. *Critical Reviews in Plant Sciences*, 24 (Corrected Proof) 2005.

Papajorgji P., Panos Pardalos. *Software Engineering Techniques Applied to Agricultural Systems: An Object-Oriented and UML Approach*. Monograph 243 pages. Springer Verlag 2005.

Papajorgji P. *A Plug and Play Approach for Developing Environmental Models*. *Environmental Modelling & Software*, Vol 20/10 pp. 1353-1357. 2005. Elsevier.

Papajorgji P., Ryan C. *Using Model Driven Architecture principles to Develop Crop Simulation Models*. World Congress of Computers in Agriculture and Natural Resources, Vila Real, Portugal, July, 2005.

Ryan C., R., Papajorgji P. *Model Driven Architecture for Software Application Generation*. World Congress of Computers in Agriculture and Natural Resources, Vila Real, Portugal, July, 2005.

Qafoku N.P., Zachara J.M. and Liu C. *Advective displacement of pertechnetate from contaminated sediments beneath tank 241-T-206*. PNNL Report (2005).

Zachara J.M, Davis J., Liu C., McKinley J., Qafoku N.P., Wellman D., Yabusaki S. *Uranium geochemistry in vadose zone and aquifer sediments from*

the 300 area uranium plume. PNNL Report (2005).

Qafoku N.P., Wellman D., Zachara J.M. and Liu C. *Advective desorption of U(VI) from TX-104 sediments*. PNNL Report (2005).

Qafoku N.P., Zachara J.M., Liu C., Gassman P., Qafoku O.S. and Smith S.C. *Kinetic desorption and sorption of U(VI) during reactive transport in a contaminated Hanford sediment*. *Environmental Science and Technology*. 39: 3157-3165 (2005).

Qafoku N.P., Sumner M.E. and Toma M. *Ion transport dynamics in acid variable charge soils*. *Soil Sci. Plant Nutr.* 51(5) (in press).

Wellman D., Zachara J.M., Smith S.C., Qafoku N.P., Liu C., Forrester S.W. *Subsurface migration of uranium from contaminated vadose zone sediments*. 229th American Chemical Society Meeting, San Diego, CA, March 2005, 13- 17.

Qafoku N.P., Zachara J.M. and Liu C. *Uranium(VI) desorption from long-term contaminated sediments*. *Goldschmidt Conference Abstracts, Geochimica et Cosmochimica Acta*, 69 (10, supplement), A470 (2005).

Zdruli P. and Trisorio Liuzzi, G. (Eds). *Workshop proceedings Determining an income-product generating approach for soil conservation management held in Marrakech, Morocco 12-16 February 2004*. Nr. 2. Medcoastland series of publications. Ciheam-Iam Bari, Italy (2005). ISBN 2-85352-311-X.

Zdruli P., Steduto P., Bogliotti C. *Fostering networking and exchange of information in the Mediterranean region: The MEDCOASTLAND Thematic Network*. In: *Desertification in the Mediterranean Region. A Security Issue*. W.G. Kepner, J.L. Rubio, D.A. Mouat, and F. Pedrazzini (Eds.). NATO Security through Science Series, Volume 3, 605p., Springer Publishers, Germany (2005). ISBN HB 1-4020-3758-9 / ISBN PB 1-4020-3759-7.

Yakti S., Zdruli P., Akça E., Pekel M., Yilmaz S., Düzenli A., Serdem M., Kapur B. and Kapur S. *Management of coastal sand dunes by agroecosystem approach*. In: *Determining an income-product generating approach for soil conservation management Workshop proceedings, Marrakech, Morocco 12-16 February 2004*. Nr. 2. Medcoastland series of publications (2005). Ciheam-Iam Bari, Italy. ISBN 2-85352-311-X. (Zdruli and Trisorio Liuzzi, Eds)

Zdruli P. *Soil survey in Albania*. In: Soil Resources of Europe, second edition. R. Jones, B. Houskova, P. Bullock and L. Montanarella (eds). European Soil Bureau Research Report No.9 EUR 20559 EN. 420 pp. Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg (2005).

Zdruli P. and S. Kapur. *Soil Atlas of Europe. Properties, characteristics, classification and management of Mediterranean soils*. Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg (In press).

Zdruli P. and Trisorio Liuzzi, G. (Eds). *Workshop proceedings Promoting participatory management of the land system to enhance soil conservation held in Alexandria, Egypt 9-13 October 2004*. Nr. 3. Medcoastland series of publications. Ciheam-Iam Bari, Italy (In press).

Hamdy A., Trisorio Liuzzi G., Zdruli P. and Morini Ch. *Multinational projects/achievements: Overcoming limits and fostering opportunities for new strategies*. In: "Promoting participatory management of the land system to enhance soil conservation" held in Alexandria, Egypt 9-13 October 2004. Nr. 3. Medcoastland series of publications. Ciheam-Iam Bari, Italy. (Zdruli and Trisorio Liuzzi, Eds) (In press).

Akca E., Pekel M., Kapur B., Zdruli P., Eswaran H. and Kapur S. *The upstream and downstream integrated resource management of the Adana anthroscape*. In: "Promoting participatory management of the land system to enhance soil conservation" held in Alexandria, Egypt 9-13 October 2004. Nr. 3. Medcoastland series of publications. Ciheam-Iam Bari, Italy. (Zdruli and Trisorio Liuzzi, Eds) (In press).

Peer-review Journals:

Zeneli G., Kola H. and Dida M. *Phenotypic variation in native walnut populations of Northern Albania*. *Scientia Horticulturae*. 105 (1): 91-100 (2005).

Zeneli G. and Marku V. *Production capacity of Douglas-fir (*Pseudotsuga menziesii* [Mirb.] Franco) in Albania*. *Ecology (Bratislava)*: 24(2): 125-137 (2005).

Book Chapter:

Schmidt A., Zeneli G., Hietala A.M., Fossdal C.G., Krokene P., Christiansen E. and Gershenzon J. *Induced chemical defences in conifers: Biochemical and molecular approaches to studying their function*. In: Romeo J.T. (ed): *Chemical Ecology and*

Phytochemistry in Forest Ecosystems. Vol. 39. Elsevier, Amsterdam. pp. 1-28 (2005).

Proceedings and Abstracts:

Erbilgin N., Krokene P., Christiansen E., Zeneli G. and Gershenzon J. *Methyl Jasmonate applied to spruce trees elicits tree defenses and interrupts host colonization by *Ips typographus**. In: *Back to the future*. 56th Western Forest Insect Work Conference. Victoria, British Columbia, Canada. March 28 - April 1, 2005.

Zeneli G. and Gershenzon J. *Another piece in the puzzle: Norway spruce volatile terpenes and protection against oxidative stress*. In: CONDEF 2005. (Conifer Defense Meeting). Oppurg-Thuringia, Germany. 11-14 June 2004.

SHKENCAT HISTORIKO-FILOLOGJIKE

Baliu B. *Vepra bibliografike e profesor Jup Kastratit* (monografi), Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2005.

Baliu B. *Mbi autorësinë e bibliografisë së Skënderbeut*, "Era", Prishtinë, 2005.

Baliu B. *Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës*, (bashkautor), "Era", Prishtinë, 2005.

Baliu B. *Konteksti shqiptaro-serb i toponimisë së Kosovës*, tek Gjuha shqipe, nr. 1/2005, IAP, Prishtinë, 2005, f. 79-85.

Baliu B. *Vepër që shënon një ngjarje shkencore dhe kulturore*, "Gjurmë albanologjike", nr. 32-33, 2002-2003, IAP, Prishtinë, 2005, f. 208-209.

Baliu B. *Hulumtim shterues i toponimisë së Ulqinit dhe rrethinave të tij*, "Gjurmë albanologjike", nr. 32-33, 2002-2003, IAP, Prishtinë, 2005, f. 223-225.

Baliu B. *Toponimia monumentale e Kosovës - Monumental toponimy of Kosova* (botim paralel shqip-anglisht), në "Monumentet e Kosovës - Kosova Monuments", Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Prishtinë, 2005, f. 147-156.

SHKENCAT MJEKESORE

Çitaku F., Rechsteiner H. *Unterrichtskonzept zum Thema Kompetent reagieren in Notfallsituationen* (Punim diplome: Koncept ligjërimit për temën Ndërhyrjet kompetente në situatat e urgjencës),

(Vijon në faqen 11)

*“Kur ulesh me një vajzë të këndshme për dy orë të duken si dy minuta,
kur ulesh mbi një stufë të nxehtë për dy minuta të duken si dy orë.
Ky është relativiteti.”*

ALBERT AJNSHTAJN

PASARDHESJA MODERNE E AJNSHTAJNIT


Lisa Randall, është një shkencëtare e re dhe tërheqëse në Universitetin e Harvardit me pasionin për majat alpine dhe majat e fizikës. Kërkimet e saj në sektorin e fizikës së energjive të larta përbëjnë një nga temat më të koklavitura të shkencës dhe e kanë çuar atë, së bashku me Raman Sundrum të John Hopkins University, në ndërtimin e modelit të një “universi me membranë”. Teoria e tyre supozon një hapësirë me dimensione 3+1 e futur në një hiperhapësirë me shumë dimensione. Ky konceptim i një universi (hapësirë-kohë) me shumë dimensione, falë pikërisht kësaj gjeometrie të re e të ndërlikuar, sugjeron shpjegime “të mundshëm” për probleme “të pamundshëm” ende pa asnjë përgjigje. Ky model i ekstra dimensioneve kënaq në realitet një kërkesë kulturele që mbështetet unanimisht nga të gjithë por nuk është mbështetur ende hapas nga eksperimentet.

Provat e para në favor të teorive (si supersimetria) që i përkasin të njejtës rrymë kërkimore mund të vijnë nga eksperimentet e Large Hadron Collider (Lhc), pëshpejtuesi i fuqishëm i grimcave, që do të fillojnë në vitin 2006 në Cern-in e Gjenevës. Lhc-ja do të bëjë të mundur arritjen e energjive të nevojshme për të parë struktura të reja të cilat do të plotësojnë skemën e materies dhe të forcave të natyrës.

“Nevoja kulturele është ajo e kapërcimit të ‘Modelit Standard’ mbi të cilin bazohet ende fizika e ndërveprimeve bazë. Ky model nuk është plotësisht i pranueshëm pasi nuk shpjegon gjithçka. Për shembull, ai nuk shpjegon përse ngarkesa elektrike e protonit dhe ajo e elektronit janë ekzaktësisht të njejtë e të kundërta, të afta të garan-

tojnë që lënda të jetë elektrikisht neutrale” saktëson Guido Martinelli, fizikan teorik nga Universiteti La Sapienza në Romë.

Kështu sot po kërkohen modele të rinj formalë që të japin një përgjigje të vetme e koherente si për forcën e rëndesës ashtu edhe për fenomenet kuantike për të cilët duhet t’iu referohesh teorive të ndryshme e pikërisht për këtë “epistemologjikisht” të pakënaqshme. “Teoria e Gravitetit universal e Ajnshtajnit dhe Modeli Standard nuk japin një kuadër teorik të plotë që të përfshijë si Relativitetin e Përgjithshëm ashtu edhe Mekanikën Kuantike, as shpjegojnë se përse ekzistojnë shkallë energjie kaq të ndryshme midis tyre. Teoritë e Lidhëseve, të përpunuara pas Gravitetit Universal, mund ti japin një zgjidhje këtyre problemeve”



shton Martinelli. Një teori të aftë që të bashkojë skemat konceptuale që në dukje janë tepër të largëta midis tyre u kërkua pa dobi nga Ajnshtajni e pak më vonë nga Theodor Kaluza e Oskar Klein. Ky i fundit hartoi modelin e hapësirës jo me tre por me katër dimensione, ku mund të gjenin vend si gravitoni (grimca që ka forcën e rëndesës) ashtu edhe fotoni (mesazher i ndërveprimit elektromanjetik).

Këto përpjekje të eksplorimit të territoreve të reja nuk patën fat të madh por u përdorën si bazë në vitet '80 në Teorinë e Lidhëseve dhe më pas të Super lidhëseve. Në këtë rrugë premtuese futen edhe studimet e Lisa Randall që përshkruajnë një univers ku gjithë materia, nga planetet tek grimcat subatomike, dhe forcat bazë (elektromanjetike, e dobët dhe e fortë) përfshihen në familjaren hapësirë-kohë me katër dimensione, ndërsa forcat e rëndesës veprojnë në gjithë hapësirën kohë me shumë dimensione. Bukuria e këtij modeli qendron pikërisht në mundësinë për të bashkuar ligjet që drejtojnë si fenomenet e makrokozmo-

sit (të përshkruar nga Relativiteti i përgjithshëm) ashtu edhe ata të mikrokozmosit (të përshkruar nga mekanika kuantike): një mundësi që e bën këtë teori një etapë të rëndësishme në afrimin që nga Modeli Standard do të çonte në Teorinë e Unifikimit të Madh (Gut)

Logjikisht lind pyetja se përse këto dimensione ekstra nuk janë në asnjë mënyrë të kapshme e bile janë tepër larg nga përvoja jonë empirike. Le të provojmë ta shpjegojmë me një shembull që banalizon në maksimum: nëse do të jetonim në një fluskë sapuni e do të mund të lëvizim vetëm para-mbrapa ose djathtas-majtas, do të perceptonim vetëm dy dimensione edhe pse fluska është e zhytur në një hapësirë tridimensionale. Le të imagjinojmë tani sikur jetojmë në një univers të ndërtuar si një membranë ku ndërthuren shumë dimensione; ne subjekte "tridimensionale" do të perceptojmë vetëm tre dimensione. Në skenarin e shkruar nga Randall e Sundrum membrana ka më shumë se katër dimensione: ndërsa tre dimensionet e zakonshme që perceptojmë normalisht kanë përmasa tepër të mëdha bile të pafundme, ekstra dimensionet jo vetëm veprojnë në një nivel tjetër, por janë segmente apo rrahtë kaq të vegjël (një e miliarda e miliardës së një centimetri) saqë iu shpëtojnë tërësisht ndjenjave tona. Llogaritë tepër të ndërlikuara të propozuara nga Randall e Sundrum në fund dalin: pra ky model është i besueshëm dhe ka të gjitha kartat në rregull për të qenë "potencialisht" i vërtetë. E nuk është pak. Por pikërisht vogëlsia e pamagjineshme dhe e pakontrollueshme e

extra dimensioneve është edhe pika e dobët e këtij modeli tërheqës: për të depërtuar në struktura tepër të ngjeshura duhen energji tepër të larta, të pa arritshme me aparatat e sotme, e përtej disa kufijve, të pa arritshme absolutisht. Brezi i ri i përshpejtuesve – e veçanërisht Lhc-ja – mund të zgjidhin disa probleme të rëndësishëm e të vërtetojnë (apo rrëzojnë) teoritë që sot apasionojnë shkencëtarët e të gjithë botës e bëjnë të vuajnë shumë, për vështirësitë e vërtetimit eksperimental, dishepujt e Galileos.

Deri më sot janë të ligjshëm dyshimet e atyre si Frank Wiczeck, që mendojnë se kemi të bëjmë vetëm me "haluçinacione të maleve të larta". Si alpiniste e zonja dhe fizikane race, Lisa Randall iu përgjigjet kolegëve skeptikë me një buzëqeshje: "Teoria jonë është një teori që tërheq vëmendjen jo vetëm të fizikanëve të grimcave por edhe të ekspertëve të fizikës relativiste dhe kozmologjisë, shumë prej të cilëve sot mendojnë se ky është një model i mundshëm. Është modeli i botës? E kush e di? Është patjetër një model elegant. E nuk është hera e parë që bukuria dhe eleganca e një teorie çojnë një shkencëtar drejt zgjidhjes më të drejtë: u ka ndodhur shumë shkencëtarëve të mëdhenj të historisë. Thjeshtë sepse metoda e bukurisë është edhe ajo që drejton mëmën natyrë".

** Lisa Randall është pedagoge e fizikës në Harvard University (Cambridge, Massachusetts, ShBA)*

Përgatiti Roland Leli

Mision në hapësirë për të fotografuar vendet historike të zbritjes në Hënë

Shkencëtarët amerikanë kanë vendosur të kryejnë një fluturim të gjatë prej 240.000 miljesh për të fotografuar zonat e ndryshme të Hënës ku kanë zbritur misionet e njëpasnjëshme Apollo. Në vitin 2008 një telekamerë e fuqishme do të dërgohet në orbitë në bordin e Lunar Reconnaissance Orbiter (LRO) përreth satelitit tonë për të fotografuar detaje e sipërfaqes së tij.

Telekamera do të bëjë foto në vendin ku u braktis moon boogy, automjeti hapësinor i përdorur nga

astronautët gjatë misionit Apollo. Kjo telekamerë do të ketë një rezolucion prej rreth gjysëm metri, i mjaftueshëm për të dalluar automjetin e braktisur me gjatësi rreth tre metra. Por qëllimi i vërtetë i këtij misioni nuk është vetëm një udhëtim mbrapa në kujtesë. Sipas ekspertëve të Nasa-s misioni i LRO-së do të jetë hapi i parë konkret për kthimin e njeriut në Hënë

The Guardian

MOTI I KASTRIOTIT DHE MITI I ZGJEDHJEVE

Agron Alibali

Danville është një qytet amerikan krejt i zakonshëm në jugë të shtetit Virxhinia. Në qendër të tij, një ndërtesë e bukur, ish shtëpia e kryetarit të bashkisë më 1865, është kthyer në muze historik dhe artistik. Motivi? Në atë ndërtesë është nënshkruar Proklamata e fundit e presidentit të Konferedatës së Shteteve Jugore, Xheferson Davis, pak para përfundimit të Luftës Civile në SHBA. Ishte pikërisht aty kur Davis mori edhe lajmin për dorëzimin e trupave të Jugut nën komandën e gjeneralit Robert E. Lee më 13 prill 1865.

Nuk kaloi as një javë nga përfundimi i Luftës Civile dhe disa qindra kilometra në veri, në Teatrin Ford të kryeqytetit Washington, një aktor i njohur do të vriste presidentin Abraham Linkoln. Teatri në fjalë është kthyer edhe ai në muze dhe vizitohet çdo ditë nga qindra vizitorë nga të katër anët e ShBA-së dhe të botës.

Viti 2009 do të jetë 200 vjetori i lindjes së presidentit Linkoln. Një komision i posaçëm ka filluar nga puna qysh tani për të organizuar festimet në këtë vit jubilar e përkujtimor.

Viti 2005

ose moti i Skënderbeut

Në trojet e Arbërit disa mijëra kilometra në lindje të ShBA-së shqiptarët kanë rastin të përkujtojnë 600 vjetorin e lindjes së heroit të tyre kombëtar, Gjergj Kastriotit. Kruja do të ishte caktuar si kryeqyteti kulturor i vendit për të nderuar kujtimin e birit të saj të madh. Mijëra turistë, vendas dhe të huaj, do të mund të vizitonin qytetin e famshëm, por edhe të kundronin shpatet e thepisura të Malit të Skënderbeut, prej nga ai lëshohej me furi kundër rrethimit otoman. Diku në Fushë-Krujë do të ishte ngritur një park kombëtar në vendin ku 550 vjet më parë ushtria më e madhe e kohës, në dy fushata të njëpasnjëshme, dështoi në nënshtrimin e shtetit të dytë të Arbërit.

Ishte Faik Konica ai që propozoi i pari në revistën *Albania* identifikimin e të gjitha fushëbetëve të Gjergj Kastriotit me otomanët dhe ngritjen e parqeve historike kombëtare në to. Gjatë këtij viti jubilar 2005, mijëra turistë vendas dhe të huaj do të vizitonin Torviollin, Beratit dhe dhjetra vende të tjera historike që lidhen me Skënderbeun. Pika të rëndësishme historike do të ishin edhe fshati Kastriot në Dibër, kalaja e Petrelës me varrin e Mamicës, Kanina, Korça, Lezha, Vlora, e shumë e shumë

të tjera. Ndërkohë, Shkodra do të kujtonte me veprimtari masive rrethimin dhe rënien e saj më 1479, kur pas disa vitesh qëndrese, shkodranët u shtrënguan të dorëzonin qytetin e tyre pas vendimit të Venedikut për të bërë marrëveshje me sulltanin. Po ashtu, Akademia e Shkencave do të mbante një konferencë studimore, ndërsa Himara dhe Gjirokastra do të përkujtonin e nderonin edhe ato Skënderbeun e madh.

Miti i zgjedhjeve

E megjithatë, shqiptarët kanë më shumë se gjashtë muaj që merren vetëm me zgjedhjet e 3 korrikut (*artikulli është shkruar pak ditë para zgjedhjeve, ndr.*). Disa thonë se këto janë zgjedhjet më të rëndësishme. Deklarata të panumërta nga institucione të ndryshme të huaja japin mendim për këto zgjedhje dhe venë theksin në rëndësinë e tyre. Ajo çka harrohet, megjithatë, është se nëse ka patur probleme në zgjedhje të kaluara, këto kanë ardhur edhe si pasojë e paaftësisë së OSBE-së dhe ODIHR-it për të hartuar një kod zgjedhor për të qenë, pas më shumë se katër vjetësh pune, tre kodesh dhe miliona dollarësh të harxhuara deri më sot. E gjithësesi, problemet kurrsesi nuk kanë vënë në pyetje shprehjen e vullnetit të shumicës, madje as në zgjedhjet e vitit 1996, kur fitorja e PD-së në përgjithësi nuk u vu në diskutim, por u diskutua vetëm madhësia e saj. Si rrjedhim, është krijuar miti sikur shqiptarët nuk dinë të bëjnë zgjedhje dhe se qeveritë e dala prej tyre nuk kanë qenë legjitime. Mjafton të kujtojmë për këtë deklarin famëkeq të z. Priebe para disa muajsh në Tiranë se duam më në fund një qeveri me legjitimitet në negociatat?

Zgjedhjet e 3 korrikut mund të kenë rezultat të ngushtë, të papritur dhe të paparashikuar. Ato në përgjithësi do të jenë të qeta dhe shqiptarët do të demonstrojnë edhe një herë nivelin e lartë të qytetarisë dhe angazhimit të tyre politik.

Nëse do të ketë probleme, këto ka të ngjarë më shumë që të krijohen në Himarë, si pasojë e provokimeve të shovinizmit grek atje. Kujtojmë se në dy zgjedhjet e kaluara ishte pikërisht Bregu vendi ku shovinizmi grek arriti që të verë në dyshim procesin zgjedhor në Shqipëri dhe të "ndërkombëtarizojë" pseudo-problemin e minoritetit etnik grek në Rivierën shqiptare. Në këtë drejtim nuk mund të mos vërejmë dhuratën e papritur e të paparë që prania e OSBE-

së i bëri shovinizmit grek kur e detyroi Shqipërinë ta ndajë Bregun si zonë zgjedhore nga Labëria dhe Vlora.

Zgjedhjet e 3 korrikut do të kryhen me sukses dhe, si të tjerat, do të harrohen shpejt. Ajo çka ka më shumë rëndësi është që paskëtaj shqip-

tarët dhe qeveritarët e tyre duhet të përqëndrohen në problemet dhe vlerat e vërteta të vendit dhe kombit, një prej të cilave është edhe përkujtimi dinjitoz i heroit të tyre të madh kombëtar.

Botuar tek gazeta *Koha Jonë*

Publikimet shkencore për 6-mujorin e parë 2005

(Vijon nga faqja 7)

Hamburg, Germany (2005).

Meyns B., Jashari R., Gewillig M., Mertens L., Komarek A., Lesaffre E., Budts W., Daenen W. *Factors influencing the survival of cryopreserved homografts. The second homograft performs as well as the first.* Published in: Eur J Cardiothorac Surg. 2005 June 11.

Jashari R. *European Homograft Bank (EHB) : 15 ans d'activité dans la sélection, préparation, cryo-conservation et distribution de valves et d'artères d'origine humaine.* Eshtë pranuar për prezantim dhe botim: 28-e Congrès Franco/Belge des 24 et 25 septembre 2005.

Tre punimet vijuese janë pranuar për prezantim në 14th International Congress of the European Association of Tissue Banks, Florence, Italy, December 8-11, 2005.

Jashari R., Van Hoeck B., Tabaku M. and Vanderkelen A. *Main causes of the human valvular and vascular rejection. Overview of a 15-year activity of the European Homograft Bank (EHB) in Brussels.*

Jashari R., Van Hoeck B., Tabaku M. and Vanderkelen A. *Comparison of the efficiency of tissue decontamination using two different antibiotic cocktails.*

Jashari R., Van Hoeck B. and Vanderkelen A. *Use of the cryopreserved mitral allograft for mitral and tricuspid reconstruction or replacement. Overview*

of a 15-year activity of the European Homograft Bank (EHB) in Brussels.

Books

Rechel B., Shapo L., McKee M. and The Health Nutrition and Population Group (Europe and Central Asia Region of The World Bank). *Appropriate health-related Millennium Development Goals for the Europe and Central Asia Region: Potential Impacts and Policy Implications.* Washington, World Bank, 2004.

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/o,,contentMDK:20248838~pagePK:146736~piPK:146830~theSitePK:258599,00.html>

<http://www.lshtm.ac.uk/ecohost/projects/mdg-europe-asia.htm>

Rechel B., Shapo L., McKee M. *Are the health millennium development goals appropriate for eastern Europe and Central Asia?* Health Policy - accepted in Dec. 2004. In press.

Shapo L. Poster presentation at the UK Annual Faculty of Public Health Conference, Scarborough 2005. *Improving breast screening services & uptake in Camden - a telephone survey with non-attenders.*

Mental health of Kosovo refugees in the UK results from a population based study. Presentation organised by The Nash Albanian Studies Programme & CSEES, London, UK. 22 March, 2005.

Shënimet e letërpërgjigjes së Alb-shkencës ndaj deklaratës së disa organizatave greko-amerikane

(vijon nga faqja 3)

tional & Property Claims in Greece. Conflict Studies Research Centre. April 2002.

HYPERLINK <http://www.da.mod.uk/CSRC/documents/balkans/G109>

Shih gjithashtu: *CIA Worldfactbook (2005): Greece.*

HYPERLINK <http://www.odci.gov/cia/publications/factbook/geos/gr.html>

Shih gjithashtu: Mete, Egerem. *Qëndrimi grek ndaj pakicave kombëtare.*

Artikull në gazetën shqiptare *Albania* në dhjetor 2000. HYPERLINK

http://www.aac1.com/Greece_Stand_on_National_Minorities.htm

Për gjendjen e emigrantëve ekonomikë drejtojnë Chtouris, Sotiris, Psimmenos, Iordanis dhe Flora Tzelepogou. *"Muslim voices" in the European Union: Greece – Muslim Minorities in Greece – From Traditional Rural communities to Migrant Network Communities: The emergence of a Global Underclass.* TSER – European Union. Research into Social Integration and Social Exclusion *"Muslim Voices" in the European Union: The Stranger Within Community Identity and Employment*, 1999.

HYPERLINK <http://www.aegean.gr/sociology/gso/en/muslim-voices.htm> [20 July 2005]

INTERVISTEN E SOTME E KEMI KRYER ME GRUPIN E TE RINJVE QE KANE KRIJUAR GRUPIN PR-TECH PER TE NXITUR DHE INKURAJUAR PERHAPIEN E DJEVE DHE TE REJAVE SHKENCORE NE GJUHEN SHOJPE

Alb-Shkenca: Përse Pr-Tech?

Pr-Tech: Pr-Tech (<http://www.pr-tech.net>) është një grup të rinjsh shqiptarë që i janë përkushtuar zhvillimit teknologjik të trojeve shqiptare. Po, po, mirë e lexuat, zhvillimit të teknologjisë së Kosovës, Shqipërisë e më gjerë. Qëllimi i Pr-Tech-ut është “infektimi” i rinisë shqiptare me virusin teknologjiko-shkencor derisa të arrihet epidemia. Fatkeqësisht ky virus i njohurive dhe fuqisë teknologjike, ende nuk është i pranishëm në masën që dëshirojmë ta shohim tek shqiptarët. Një gjë e tillë mund të vërehet tek mungesa e informacionit të mirëfilltë bazë për teknologji e shkencë në gjuhën tonë. Pr-Tech e vuri re këtë mungesë dhe mundohet që të përhapë këtë virus përmes internetit, duke publikuar punime, shkrime, mësimë të shkurta në kompjuterikë e inxhinieri në përgjithësi por edhe lajme nga nanoteknologjia, bioteknologjia, shkencat e materialeve, energjetika, mjedisit dhe ekologjia, fizika, astronomia, paleontologjia, mjekësia, antropologjia, transporti etj.

Punimet zakonisht janë ata që ne (të gjithë kontribuesit) bëjmë nëpër universitete gjatë vitit shkollor, të cilat i përkthejmë e i përshtatim për Pr-Tech në gjuhën shqipe. Qëllimi është që të krijohet një faqe ku mund të gjendet literaturë edukativo-shkencore në gjuhën tonë për studentë të nivelit të universitar.

A-Sh: Kush jeni ju?

Pr-Tech: Jemi një grup të rinjsh, të gjithë studentë (disa i kanë kryer studimet) në anë të ndryshme të botës. Pr-Tech u themelua nga pesë shokë që shoqërohemi e punojmë qysh në shkollë të mesme (1999-2001), ku edhe aspiratat e ngjashme na bënë të lidhemi me shumë me njëri tjetrin dhe të krijojmë diçka si projekti Pr-Tech. Por nuk mbetëm të vetmuar pasi në vite na u bashkuan shumë të rinj të tjerë me të njëjtat qëllime të cilët ndajnë, shkruajnë e përkthejnë punime nga universitetet e shkollat e tyre. Kontribuesit vijnë nga të gjitha trevat shqiptare e shumë prej tyre ndodhen në ShBA e Europën Perëndimore, gjë që na mundëson edhe të shkëmbejmë përvojat e universiteteve të ndryshme. Lista e plotë e kontribuesve mund të shihet në faqen tonë.

A-Sh: Çfarë keni studiuar apo po studioni, përse, ku dhe çfarë dëshironi të bëni më pas?

Pr-Tech: Ne në Pr-Tech jemi të gjithë studentë (apo pas universitarë). Tre prej nesh studiojnë në ShBA, një në Zvicër dhe një në Prishtinë. Kontribuesit e tjerë, siç e cekëm më lart, vijnë nga ShBA-ja, BE-ja, dhe trojet shqiptare. Në përgjithësi, të gjithë studiojmë lëmi inxhinierike (shumica shkencave kompjuterike, inxhinieri elektrike, matematikë dhe biznes). Kemi mungesë të studentëve të bioinxhinierisë, fizikës, kimisë dhe shkencave si antropologjia. Përveç studimeve, punojmë në shoqëri dhe institucione të ndryshme si praktikantë ose të rregullt. Qëllimi kryesor është që të gjitha përvojat ti përdorim në vendin tonë.

A-Sh: Nga vini dhe ku do shkoni?

Pr-Tech: Ne nuk do të ndalemi, kjo është e pamundur sepse ka shumë punë për të kryer. Nuk do të ndalemi edhe kur ky “virus” të arrijë përmasa epidemike, kur të forcohemi si popull/shtet. Kemi filluar me web-faqe dhe projekte dixhitale dhe do të organizojmë konferenca të shpeshta shkencore për studentët në Kosovë e Shqipëri ku do të kemi mundësi (më të mëdha) për “infektimin” e rinisë.

A-Sh: Bëni një përshkrim të shkurtër të punës shkencore që po bëni ose që doni të bëni. Përse e dëshironi një punë të tillë?

Pr-Tech: Mementalisht ekipi i Pr-Tech-ut ka orientime të ndryshme për shkak të largësisë, prandaj punojmë në projekte të ndryshme. P.sh. Genc K. është duke zhvilluar një aplikim për statistika automatike të serverëve të organizatës The Global Fund në Gjenevë; Krenari punon për një shoqëri në ShBA që merret me radio frekuencat dhe bën analizimin e sinjaleve të standardeve të ndryshme për telefonat celularë si GSM, CDMA2K, 802.11, WCDMA dhe EDGE; Betimi vazhdon të punojë si student në Institutin e Hulumtimeve të Marsit në ASU.edu, për të zhvilluar softuerin që mbështet instrumentin Themis në fluturaken Mars Odyssey të Nasa (<http://themis.asu.edu>); Bleroni vazhdon të punojë si këshilltar IT dhe hulumton për pajisje për telefoninë përmes internetit (VoIP); Genc D. vazhdon të merret rregullisht me aplikimin e inxhinierisë softuerike në biznes. Vitin e ardhshëm shumica e themeluesve të Pr-Tech-ut do të mbarojë studimet, kështu që planifikojmë që të kemi edhe projekte që kërkojnë pranimë fizike në vendet e duhura.

Pr-Tech është ide, jo vetëm faqe interneti apo punë e disa personave, por është diçka që tenton të shndërrojë dhe ndryshojë gjendjen e tanishme në trojet tona. Bota është duke ndryshuar, e njëkohësisht edhe ne me të. Si popull kemi shumë punë

përpara, që të fitojmë respektin dhe admimirin ndaj të tjerëve e në radhë të parë ndaj vetvetes, me punë e jo me fjalë. Madje edhe kjo mund të jetë motoja e Pr-Tech-ut “Më shumë punë, më pak fjalë”. Ne duhet të orientohejmë edhe në teknologji e jo vetëm në shkencë shoqërore (ku po investohet më shumë në rajon). Kjo punë bëhet me kënaqësi, dhe në këtë botë e cila po ndryshon, përgjigja qëndron në kokat e njerëzve, në njohuri dhe vullnet e

jo në burime tokësore të cilat vazhdimisht po konsumohen në këtë planet. Shqiptarët kanë mundësi të shumta të përparojnë dhe të shndërrohen në fuqi serioze të Europës Lindore. Vullneti ekziston, njerëzit ekzistojnë, njohuria ka filluar të pasurohet. Me veprimet tona dhe të të tjerëve realizimi i këtij vizioni do të arrihet më shpejt.

Përgatiti Dr. Albana Rexhepa

Revista *Malësia*, nr. 1

Radhës së revistave me karakter shkencor, të cilat botohen në gjuhën shqipe në Mal të Zi iu shtua edhe një titull i ri: *Malësia*, revistë për kulturë, shkencë dhe çështje shoqërore, numri i parë i së cilës doli kohët e fundit. Nëse *Lemba* dhe *Dija* janë botuar në Ulqin, revista *Malësia* sikur deshi të zinte vendin e lënë bosh të revistës, dikur të vetme dhe me karakter shkencor e kulturor në Mal të Zi, *Koha* ka filluar të botohet në Podgoricë dhe ka kryeredaktor Nikë Gashajn. Në redaksinë e saj ka mbledhur një numër personalitetesh shkencore e kulturore të kësaj ane: prof. dr. Ruzhdi Ushaku, prof. dr. Nikë Ujkaj, prof. dr. Ibrahim Ahmetaj, mr. Riza Rexha.

Duke filluar me fjalën hyrëse vihet re se revista pretendon të jetë një botim i një mesazhi bilingual: shqip, serbisht dhe anglisht, ndonëse, siç thuhet në editorialin saj, qëllimi i publikimit është evidentimi i thesarit kombëtar të shqiptarëve në Mal të Zi, komunikimi me vlerat më të rëndësishme kombëtare në gjithë rajonin dhe më gjerë, si dhe prezantimi i koncepteve humaniste të inteligjencës malazeze e botërore për çështje të rëndësishme kulturore, shkencore dhe humanitare.

Vëllimi i parë është ndarë në disa rubrika, të cilat nuk janë standarde, por që iu përgjigjen temave të trajtuara brenda këtij vëllimi.

Në rubrikën “Histori” janë botuar dy studime me interes për çështjen shqiptare, në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, nga historiani mr. Riza Rexha dhe historiani e diplomati dr. Haris Silaixhiq, të cilat trajtojnë problemin e coptimit të trojeve shqiptare gjatë periudhës së Kongresit të Berlinit dhe kontributin e diplomacisë shqiptare dhënë zgjidhjes së problemit të shqiptarëve gjatë Konferencës së Paqes në Paris, 1919-1920.

Ndërsa dy studimet e para çështjen shqiptare e shohin nga këndi i historisë, dy studimet e rubrikës “Politika”, e shohin nga perspektiva e së ardhmes politike. Studuesit Peter Shubert dhe Steffie Lamers në tesktet e tyre trajtojnë problemin e identitetit shqiptar në kohën e integriteteve evropiane dhe problemin e rajonalizimit evropian, si dhe bashkëpunimin tejkufitar, një te-

më kjo tepër e ndjeshme si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, në kontekstin e Evropës së bashkuar.

Në rubrikën “Kulturë” botohet një artikull mjaft interesant i profesoreshës Sonja Tomoviq Shundiç, e cila merret me një temë mjaft të diskutuar vitet e fundit: personalitetin dhe kulturën.

Një rubrikë mjaft e pasur është edhe ajo e emërtuar “Toponomastikë dhe albanologji” (do të mjaftonte të thuhej vetëm “Albanologji”) në të cilën janë botuar dy studime nga fusha e toponimisë. Prof. dr. Ruzhdi Ushaku në studimin e tij sprovë për shpjegimin e prejardhjes së emërvendit Valkal, ka sjellë një koncept të ri për këtë oronim të njohur historik (madje jo vetëm të tij), ndërsa dr. Pjetër Gjuravçaj sjell të dhëna interesante për ndikimin e orientalizmeve në të folmen e Malësisë së Mbishkodrës (Hot, Grudë, Triepsh dhe Kojë).

Në një vend ku turizmi është një prej burimeve themelore në jetën e banorëve, është krejt e kuptueshme që në botimet e këtij lloji të zerë vend më vete. Në rubrikën “Turizëm dhe demografi” janë botuar dy studime të ekspertëve të njohur të kësaj ane. prof. dr. Nikollë S. Ujkaj në artikullin e tij merret gjerësisht me rëndësinë e zhvillimit të turizmit për komunat e bregdetit malazet, ndërsa gjeografi prof. dr. Nail Draga merret me ndryshimet kombëtare që ka pësuar popullsia e Malit të Zi, sipas regjistrimit të vitit 2003.

Rubrika e fundit merret me problemin e “Mbrojtjes së pakicave”, përkatësisht të pakicës kombëtare shqiptare në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Serbi. Rubrikës i prin analiza e prof. dr. Dushan Janjiq, i cili merret me problemin e decentralizimit në Mal të Zi dhe mbrojtjen e pakicave, ndërsa në vazhdim prof. dr. Vili Kimlika e trajton në mënyrë mjaft të shkoqitur çështjen e multikulturalizmit dhe pakicave. Po këtu, Nikë Gashi diskuton arsyeshëm të ardhmen e Malit të Zi dhe problemin e pakicave, Naser Zyberi elaboron statusin kushtetues-juridik të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë pas Marrëveshjes së Ohrit, ndërsa Behlul Nasufi sjell një histori të shkurtër të pozitës së shqiptarëve në tri komuna të Luginës së Preshevës: Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje.

Dr. Begzad Baliu

TE VERTETAT SHQIPTARE TE BUTRINTIT

Mentor Nazarko

Ndërsa Shqipëria politike po konsumon lajme të lidhura me zgjedhjet parlamentare, ajo historike, por dhe ajo moderne, po përmenden në qarkun mediatik botëror edhe për kulturën e qytetërimin e lashtë që ajo mbart, duke ofruar një tjetër pamje të vendit në përgjithësi. E ndërkohë në qarkun mediatik botëror, rrallë në atë shqiptar diskutohet se çfarë përfaqëson vendimi i fundit i UNESCO-s, organizmi kryesor i OKB-së për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore botërore, për nxjerrjen e qendrës arkeologjike të Butrintit nga lista e trashëgimive të mbrojtura dhe futjen e Gjirokastrës, si qytet kështjellë në këtë listë tash e mbrapa.

Në një shikim të parë dhe përmbledhës, ajo çfarë mund të thuhet është se heqja e Butrintit në fakt është njohje dhe nderim për aftësinë e shqiptarëve, natyrisht bashkë me partnerët e tyre ndërkombëtarë, ku veçohet mbështetja e Lordit Rotchild dhe e grupeve të ndryshme angleze, për të mbrojtur një trashëgimi kulturore aq të pasur, si ajo e Butrintit. Në momentin e përzgjedhjes së Butrintit për t'u mbrojtur doli parësor një vlerësim i një lloji tjetër: kultura që përfaqëson dhe përfaqëson ai sit arkeologjik pranohet nga ekspertët e UNESCO-s se ka rëndësi universale, ndërsa në momentin e heqjes nga lista disa vjet më vonë rezultojnë një vlerësim tjetër: vendi i ka kapacitetet njerëzore për ta ruajtur atë qendër arkeologjike. Këto kapacitete janë të provuara dhe të çertifikuara për ta bërë një gjë të tillë. Kështu po ndodh me Gjirokastrën: pas një lobingu të gjatë disa vjeçar ku u përfshinë shkrimtari i famshëm Kadare, presidentët e Shqipërisë, kryeministrat, autoritetet vendore e miq të huaj, Gjirokastra mori statusin e trashëgimisë kulturore botërore që po rrezikohet. Prej këtej duket se lindin angazhime të mëdha për ata që marrin përsipër ta ruajnë këtë trashëgimi; atyre u duhet të mobilizojnë më tej vëmendje dhe para ndërkombëtare dhe vendase për ta ruajtur. Gjirokastra kërkon me të vërtetë një angazhim ndoshta shumë më të madh se Butrinti, për shkak të burimeve më të mëdha financiare që kërkohen, për shkak të veçorive të veta që mund të vihen në efikasitet ndoshta me një vështirësi më të madhe, për shkak të mbivendosjes së autoriteteve që duhet të menaxhohen këtë mbështetje. Por, ndërkohë shembulli i mirë ekziston: Butrinti.

Butrinti si dëshmi e vlerësimit ndërkombëtar, por dhe e përplasjeve për menaxhimin e tij. Ndërkohë në mënyrë diku të hapur, diku të fshehtë Butrinti, më saktë menaxhimi i tij është duke u shndërruar në një mollë shërr. Në emër të menaxhimit të fondeve apo projekteve të një madhësie të caktuar financiare, ndjeshmëria të caktuara lokale dhe ndërkombëtare, individë të ndryshëm janë duke u mobilizuar, madje duke argu-

mentuar të kundërtën e atij që është përfundimi i UNESCO-s, ndërsa vendosi heqjen e Butrintit nga lista e siteve të rrezikuara. Pra, Butrinti, thonë këta, është menaxhuar keq, dhe duhet ta mbrojmë atë më mirë.

Rasti më i fundit, megjithëse kritikë banale për një aspekt të caktuar të menaxhimit të tij – mungesa e cilësive të mira të ciceronëve – ishte intervista e një specialisti të Institutit të Arkeologjisë për Jugun, botuar tek *Metropol* numrin e kaluar. Në këtë shkrim madje flitej se ciceronët do të sillleshin prej Korfuzit dhe Janinës, pasi këta tanët janë duke na bërë qesharakë në sytë e botës. Pra, i kërkohej ndihmë Greqisë për të na ofruar ciceronë. Siç mund të kuptohet, përveç shqetësimit për cilësinë e keqe të menaxhimit, nga ky zë kritik shqiptar rezultojnë dhe një ftesë apo një projekt për të thirrur në ndihmë grekët për të mbrojtur Butrintin dhe për ta paraqitur më mirë atë në sytë e botës. Në një shkrim tjetër botuar tek *Times* i Londrës, nga arkeologu anglez, drejtues i kërkimeve në Butrint, Richard Hodges, ngrihej shqetësimi për një vendzbulim tjetër të rëndësishëm në trualin shqiptar, si ai i Apolonisë, i cili kërcënohej prej ndërtimit të rrugës kombëtare. Një shkrim i tillë në një gazetë prestigjioze britanike dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo vinte gishtin tek paaftësia e shqiptarëve për të menaxhuar pasuritë e tyre arkeologjike, provokoi reagimin e qarqeve greke për këcënimin që i bëhej kësaj qendre të kulturës helenistike. Edhe ky reagim u përfshi në qarkun mediatik botëror.

Ka dhe fakte të tjera që duan të vënë gishtin tek paaftësia e shqiptarëve për të menaxhuar këto pasuri, që në një shikim ndërkombëtar mund të rezultojnë edhe të besueshme, duke ditur dhe pranuar imazhin jo fort të mirë që kemi ne shqiptarët në këtë plan. Ka dhe përpjekje për të ndikuar donatorët që të evitojnë partnerët shqiptarë në këtë bashkëpunim për mbrojtjen e Butrintit, përpjekje që kanë krijuar dhe probleme gjysmë diplomatike. Tani këtyre përpjekjeve u shtohen dhe projekte që kanë në mes grekët, që do ofrojnë ciceronë; grekët që qajnë për Apoloninë etj.

Kritikat e padenja ndaj Tares

Autori i shkrimit nuk ka kompetencë për të gjykuar në një plan profesional vlerën e Butrintit, apo atë çfarë kanë arritur autoritetet shqiptare në drejtim të mbrojtjes së tij dhe atë se ç'mund të bënin vetëm anglezët nëse do të merreshin me këtë punë, apo dhe grekët. Por ka disa të vërteta që duhen përsëritur me forcë dhe që rrëzojnë pretendimet e zërave të veçantë kritikë ndaj asaj që është bërë deri më sot në Butrint. Në një farë mënyre dhe kundër vendimit

të UNESCO-s, që vlerësoi pikërisht atë që shqiptarët kanë bërë atje.

Butrinti sot, falë përpjekjeve të jashtëzakonshme të një shqiptari të jashtëzakonshëm si Auron Tare, ka shërbyer për një kohë të gjatë, si njeri nga pak lajmet e mira për Shqipërinë në të gjithë mediat më të rëndësishme ndërkombëtare, pra si vitrina e saj më e mirë në sytë e botës. Kjo ka ndodhur qysh prej vitit 1997, kohë kur Tare punonte thujse i vetëm, me pak të apasionuar të tjerë, mes plumbave për të mbrojtur Butrintin. Nuk kishte asokohe para ndërkombëtare që shkonin në Butrint, por ai qëndronte vetëm me pasionin e tij shqiptaromadhi në atë “cep të humbur” të Shqipërisë. Falë përpjekjeve të filluara prej tij mbërritën atje donatorë të rëndësishëm; u orientuan drejt përpjekjet e tyre, mbërritën grupe studimore nga e gjithë bota. Auron Tare pati mundësinë të ishte ciceroni i vlerësuar i shumë personaliteteve me rëndësi botërore, qofshin politikanë, çmime Nobel, figura të artit dhe të kulturës botërore. U shmangën projekte ekonomike që mund të shkatërronin Butrintin dhe natyrën përreth, duke e shndërruar atë në një qendër të turizmit masiv, siç ishte projekti maltez apo projekte të tjera. U shmangën përpjekje individuale për të përfutur prej bukurive natyrore të zonës, të filluara qoftë nga nevojat për mbijetesë, qoftë nga lakmia e shqiptarëve, banorë të fshatrave përreth. U shmangën projekte infrastrukturore që mund të dëmtonin kërkimet e ardhshme siç ishte projekti i rrugës Konsipol-Sarandë. U hartuan programe bashkëpunimi me këta banorë në disa vendbanime me një rëndësi simbolike të jashtëzakonshme jo thjesht në planin arkeologjik. Në atë pikë të kufirit të Shqipërisë me Greqinë, banojnë dhe bashkëjetojnë shumë mirë minoritarë grekë me qytetarë me origjinë çame, me shqiptarë të tjerë me prejardhje nga Veriu i Shqipërisë, apo me të tjerë banorë autoktonë, të cilët në mënyrë të ngadaltë, por të sigurt, po përfitojnë nga mbrojtja dhe mbrojtësit e Butrintit, nga projektet e zhvillimit të turizmit që kanë në qendër Butrintin. Banka Botërore, por dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë, universitete të huaja, duan të bashkëpunojnë me Butrintin. Falë gjithë kësaj pune gjigande, që nuk mund të shkëputet prej emrit të Auron Tares, që në mënyrë burracake nuk përmendej prej të intervistuarit në një artikull të shtypit që kërkonte ciceronë nga Korfuzi dhe Janina, Saranda vizitohet nga turistë të huaja, që vijnë prej Korfuzit për të vizituar më së pari Butrintin. Butrinti pra është kthyer në një nga krenaritë e Shqipërisë, në mos një nga më të mëdhatë e saj në planin ndërkombëtar. Nuk mund të them nëse Butrinti përfaqëson vlerën më të rëndësishme arkeologjike të Shqipërisë, por Tare me punën e tij, bashkë me të tjerë shqiptarë dhe të huaja, e ka shndërruar në më të rëndësishmen hë për hë.

Por, ka dhe një aspekt tjetër, jo aq shumë arkeologjik të kontributit të Tares. Ai ka shërbyer në Sarandë si përfaqësuesi më i përkushtuar i polit kulturor shqiptar në planin rajonal: në një shtëpi të mobiluar sipas shijeve të vjetra shqiptare, ai ka plotësuar dhe më tej marketingun e vlerave kombëtare për shumë prej të huajve, gazetarëve apo studiuesve, bujtës të saj, që kanë ardhur në Butrint falë joshjes që vetë Tare ka ditur të stimulojë me guidat që ka përgatitur, me vëmendjen ndërkombëtare që ka ditur të zgjojë rreth Butrintit. Tare ka ditur të bashkojë në Butrintin ku mbivendosen qytetërimet antike festivalin ndërkombëtar të teatrove me artizanatin shqiptar, me garën e fyejve jo vetëm lebër dhe të folklorit në përgjithësi. Ai ka ditur të ruajë shqiptarizmin në një zonë, ku më së shumti puna e tij ka provokuar xhelozinë jo vetëm turistike të fqinjëve nga Korfuzi, që transmetojnë ende publicitet me Shqipërinë e vitit 1997. Ai ka mbajtur në këmbë një radio ndoshta të padëgjueshme prej snobëve, me muzikë dhe mesazhe shqiptare, në një qytet ku në kishë meshohet vetëm greqisht. Ai është përpjekur të ruajë pasuritë arkeologjike të pazbuluara të nëntokës, ku mbivendosen qytetërimet helenistike, romake, veneciane, ilire nga kërcënimet banale të gjoja simboleve fetare, që inkurajohen të vendosen prej disa qendrave të dyshimta politike fqinje e që duan të krijojnë konflikte qytetërimesh mes shqiptarëve dhe grekëve. Tare ka rritur shpresën e të rinjve të Sarandës se ka kuptim të jetohet në qytetin e tyre: ai ka bërë që ata të duan arkeologjinë dhe historinë e trojeve të tyre.

Mund të vazhdoja dhe më gjatë, por është e panevojshme. Të kritikosh me emër dhe pa emër Auron Taren, pas një kontributi kaq të jashtëzakonshëm të ndërtuar me punën e tij në një Shqipëri përgjithësisht dembele, nuk është thjesht xhelozia. Është dëshirë për të menaxhuar dhe zhvatur paratë e projekteve ndërkombëtare, për të cilat ai është një nga pikat më të rëndësishme të referimit. Është dëshirë për të manipuluar me historinë. Është xhelozia brezash studiuesish, që diskutojnë aftësitë e tij profesionale për të cilat edhe unë mund të kem dyshim, por jo sigurisht për ato të një menaxheri të aftë, siç e kërkon një detyrë si ajo që ai mbulon. Sot, disa ditë pas vendimit të UNESCO-s, që nderon këtë kontribut edhe të Tares, sulme të tilla nuk duken thjesht qesharake dhe të padenja. Por dhe me një prapavijë politike dhe pse jo antikombëtare. Që kërkon të manipulojë me ndryshimin e qeverisjes pas zgjedhjeve dhe me atë që është pjesa më e keqe e imazhit tonë si popull: paaftësinë për të administruar vlerat tona kombëtare.

Shkrim i botuar edhe në gazetën Metropol

1 korrik 1979 – Walkmani i parë
Të shëtisësh e të dëgjosh muzikë njëkohësisht u bë e mundur në vitin 1979 kur Sony prodhoi walkmanin e parë model TPS-L2. I përgatitur si instrument pune për gazetarët, regjistruesi i ri portativ që peshonte gati 500g. u kthye në një objekt me sukses mahnitës duke shënuar fillimin e epokës së kasetave audio në dëm të disqeve. Versioni modern i tij është modeli NW-E3 që peshon vetëm 33 g. dhe i lidhur me një Pc mund të magazinohet deri në dy orë muzikë në formatin Mp3 (file audio me dimension të vogël).

2 korrik 1900 – Zepelini i drejtueshëm
Kush e pati privilegjin të udhëtojë me disa ballona aerostatikë luksozë para erës së avionëve?
Balloni i parë i drejtueshëm i pilotuar nga baroni gjerman Ferdinand Von Zeppelin fluturoi për një kohë prej 18 minutash më 2 korrik 1900 dhe fluturimet e para për pasagjerë filluan vetëm në vitin 1910 e u mbyllën me tragjedinë e zepelinit gjerman Hindenburg në një fushë në New Jersey më 6 maj 1937, kur vdiqën 13 pasagjerë dhe 22 pjestarë të ekuipazhit.

3 korrik – Luleshtrydhe mbretërore dhe banane popullore – Luleshtrydhja siç e njohim sot është rezultat i kryqëzimit të llojeve të ndryshme të bimëve të egra nga vende të ndryshme si Kili, Virxhinia (ShBA) dhe Europa. Nismëtar u bë botanisti anglez Michael Keens që në korrik 1806 paraqiti kultivarin e tij të parë në Shoqërinë Mbretërore të Kopshtarisë. Fruti i kuq e plot lëng i familjes së trëndafiloreve pati sukses të menjëhershëm. Por, sot fruti që konsumohet më shumë është bananja që renditet në vendin e pestë ndër prodhimet bujqësore më të kërkuara në botë.

6 korrik 1885 – Virus në luftë për jetën
Biologu francez Lui Pastër kryen vaksinimin e parë të historisë duke i injektuar me sukses anti-tërbimin një fëmijë të kafshuar nga një qen rrugë. Vaksina ishte një ekstrakt i palcës kurrizore të pulave të infektuara nga tërbimi. Kështu Pastëri vërtetoi se duke injektuar të njëjtët mikroorganizma, viruset që shkaktojnë sëmundjen, nxitit mbrojtja imunitare e trupit. Fitorja mbi disa sëmundje infektive e vdekjeprurëse si tuberkulozi, falë kontributit shkencor të Pastërit e Kohut çoi në një zgjatje të konsiderueshme të jetës mesatare në atë kohë.

8 korrik 1998 – Kampionati Robocup
Në Paris paralelisht me finale të kampionatit botëror të futbollit u organizua edhe kampionati i parë botëror i robotëve "Robocup". Ishin robotë të vërtetë që praktikonin sportin më popullor në botë. Ky eksperiment përveç mënyrës zbavitëse të prezantimit të futbollit, ishte një etapë e rëndësishme në studimin dhe zhvillimin e inteligjencës artificiale. Në fushën e lojës ishin robotë që simulonin nëpërmjet telekamerave, sensorëve e çipeve lëvizjet njerëzore duke qenë të aftë të kryejnë një shpirt të vërtetë skuadre.

9 korrik 1856 – Fitorja e së alternuarës
Nicolas Tesla, i lindur në Kroaci në korrik 1856, realizoi më 1891 një hidrocentral të rëndësishëm në ujvarat e Niagarës duke nxjerrë në pah epërsinë e rrymës së alternuar mbi atë të vazhdueshme për përdorim industrial e shtëpiak. Nga ky moment u ndez një debat i ashpër midis Teslës e Tomas Edisonit që ishte mbështetës i flaktë i rrymës së vazhdueshme. Ky i fundit e quajti rrymën e alternuar një instrument vdekjeje pasi me të ushqehesh edhe karrigja elektrike. Për këtë të dy humbën edhe çmimin Nobel që u ishte caktuar në vitin 1912.

10 korrik 1939 – Fati i yjeve
Fizikanët amerikanë Robert Oppenheimer e Hartland Snyder formuluan teorinë e vrimave të zeza në univers. Në fazat e fundit të jetës yjet pësojnë një kontraktim të pashmangshëm duke formuar një vorbull që thith gjithë lëndën e kjo forcë tërheqëse është kaq e madhe sa edhe drita nuk del dot më. Kështu ylli shuhet por vorbulla gravitacionale që le pas vazhdon të gllabërojë gjithçka që gjen përreth: kjo është vrima e zezë. Vrima më e afërt me Tokën quhet V4641Sgr e ndodhet 1600 vjet drite (1 vit drite = 9500 miliardë kilometra).

11 korrik 1975 – Gati mrekullia e tetë
Disa arkeologë kinezë lajmërojnë botën për atë që do të quhet zbulimi më i rëndësishëm i shekullit XX: gjetja e "ushtrisë së terrakotës". Janë 6000 statuja ushtarësh me madhësi natyrale që ruajnë hyrjen e varrit të perandorit Chi She Huang Ti, të periudhës rreth vitit 221 para Krishtit. Ushtarë dhe kuaj janë me veshje lufte. Fytyrat janë të ndryshme njera nga tjetra e disa kanë edhe shenja por ajo që i bën të veçantë është shprehja e tyre serioze dhe e patundur sikur duan të tregojnë një farë trishtimi e zhgënjimi ndoshta nga tirania e "Perandorit të Verdhë".

13 korrik 1944 – Rubiku i përjetshëm
A e keni pyetur veten vallë se përse nuk plotësoni më shume se një faqe të kubit të Rubikut? Ndoshta sepse ky objekt i ndërlikuar zbavitës ka plot 43.252.003.274. 489.856.000 (43 kuintilionë) konfigurime të mundshëm dhe një zgjidhje të vetme. Jo rastësisht degëzimet matematike të tij studiohen në Massachusetts Institute of Technology (MIT). Koha më e mirë në kompozimin e kubit është arritur nga një vietnamez 16 vjeçar që në vitin 1982, me kohën 22.95 sekonda, fitoi kampionatin botëror të kubit në Hungari, vendi ku më 13 korrik '44 lindi Erno Rubik.

15 korrik 1869 – Gjalpi artificial
Napoleoni i III-të ngarkoi kimistin Hippolyte Megé Mouriés, të krijonte një gjalpë artificial për ta përdorur gjatë fushatave të luftës e të mos ngrinte lehtë. Ai pas shumë vitesh eksperimentimi më 15 korrik 1869 prodhoi margarinin, një përzjerje salloje, uji, qumështi e gjinj lope të grirë hollë me ngjyrë perle nga e cila vjen edhe emri sipas greqishtes "márgaron". Sot margarina është një yndyrë bimore e emulsionuar (përzjerje lëndësh të patretshme midis tyre) e përbërë nga vajra me natyrë të ndryshme, nga vaji i misrit e i sojës tek ata të bimëve tropikale.

16 korrik 1866 – Një zbulim që djeg
Një nga çmimet më prestigjioze, çmimi Nobel, është i lidhur në një farë mënyre me këtë datë kur inxhinjeri suedez Alfred Nobel arriti të prodhojë një eksploziv që në ndryshim nga nitroglicerina ishte më në fund i qendrueshëm: dinamiti, eksplozivi i parë modern. I pasuruar nga shpikja e tij, Nobeli i trembej gjykimin të njerëzimit pas vdekjes për këtë zbulim që mund të konsiderohej njeri nga më të rrezikshmit e shekullit. E, për këtë ai në testamentin e tij vendosi që të gjithë paratë ti linte për arritjet në fizikë, kimi, mjekësi, letërsi e paqe.

17 korrik 1902 – Kondicionim nga mjegulla
Në Pittsburgh ishte një mbrëmje me mjegull të dendur e Willis Carrier po priste një tren në stacion. Gjatë udhëtimit ai filloi të mendojë mbi mjegullën e duke bërë disa përllogaritje mbi raportin temperaturë-lagështi përpunoi principin e parë të sistemeve të kondicionimit të ajrit. Impiantët e parë u vendosën vetëm në fabrika e nga fundi i viteve '20 kondicionatori i ajrit u shndërrua në një sistem tepër të kushtueshëm edhe për apartamentet e banimit.

20 korrik 1937 – Shpërndarja e valëve
Në moshën 61 vjeçare vdes Guglielmo Marconi që në 12 dhjetor 1901 në një nga eksperimentet më të rëndësishëm të historisë, me anë të dy antenave të vendosura në të dy brigjet e Atlantikut arriti të transmetojë, nëpërmjet valëve elektromagnetike, tre sinjale të shkurtër (tre klike në alfabetin Morse është gërma S). Lindi kështu transmetimi pa fije që i dha Markonit 35 vjeçar çmimin Nobel në Fizikë. Më pas, amerikani Reginald Fessenden, transmetoi më 1906 një pjesë muzikore me violinë e një lexim të ungjillit natën e Krishtëlindjes.

26 korrik 1895 – Një martesë "me interes"
Në këtë datë Marie Sklodowska e Pier Curie martohen në Francë e kjo lidhje bashkëshortore kthehet në një kurorëzim suksesi shkencor. Në laboratorin e tyre të vogël ata kishin filluar të studiojnë tonelata mbeturinash urani që vinte nga minierat boheme e pas disa vitesh ata zbuluan radiumin, një element që lëshon rreze me intensitet një milion herë më të lartë se urani, gjatë një procesi të quajtur radioaktivitet. Më 1903 ata morën çmimin Nobel dhe e vunë zbulimin e tyre në dispozicion të mbarë shkencës.

30 korrik 1863 – Mekaniku autodidakt
Makinën e tij të parë, Henri Ford i lindur më 30 korrik 1863, e ndërtoi kur ish 33 vjeç e jetonte duke ndrequr orë. Më pas ai themeloi Ford Motor me ndihmën e një tregëtar qymyri e u shndërrua në një industrialist të suksesshëm. Ideja për të shkurtuar kohën dhe koston e prodhimit të veturave me futjen e metodës së re të punës "zinxhiri i montimit" mundësoi prodhimin e makinave në seri me çmime të arsyeshme për të gjithë (pothuajse). Ford T, ishte shembulli i parë e nga viti 1908 inauguroi erën e automobilizmit të masës së gjerë.

<http://www.alb-shkenca.org>
<http://alb-net.com/pipermail/alb-shkenca>